



Integrated Water Resources  
Management in Kosovo

## PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË RESURSEVE UJORE NË KOSOVË (IWRM-K) – FAZA 2

Maj 2024 –Prill 2029

### Skema e Granteve Konkurruese Ref: CEI-CGS-2026-001

#### Ftesë për Shprehje Interesi për

**Përzgjedhjen e Komunave Pilot në Kosovë për  
Zhvillimin e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë dhe  
Projekteve të tjera Komunale të Financueshme për  
Përmirësimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

**SKAT** Partners for Impact

**ENVIRONMENT  
AGENCY  
AUSTRIA**

## FORMA E FTESËS

<b>Programi për Menaxhim të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K)</b>	<b>DATA: May 28, 2026</b>
	<b>REFERENCA:</b> Ftesë për Shprehje Interesi për Përzgjedhjen e Komunave Pilot në Kosovë për Zhvillimin e Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë dhe Projekteve të tjera Komunale të Financueshme për Përmirësimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore

I nderuar Zotëri/Zonjë,

**Programi për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë** (në vijim Programi ose IWRM-K) i Qeverive të Zvicrës dhe Kosovës synon të ndërtojë kapacitete afatgjata për menaxhimin e resurseve ujore në nivel kombëtar dhe të pellgjeve lumore, në përputhje me prioritetet socio-ekonomike dhe politike të Kosovës, si dhe nevojat për zhvillim të qëndrueshëm (për më shumë informata mbi Programin, ju lutemi vizitoni: IWRM-K Kosovo).

Si pjesë e **Skemës së Granteve Konkurruese (SGK)**, Programi tani fton **komunat në Kosovë me deri në 35,000 banorë**, të cilat i përmbushin kriteret e mëposhtme, të aplikojnë për mbështetje për **zhvillimin e dokumentacionit teknik dhe/ose projektues** për projekte prioritare komunale që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore, me fokus të veçantë në **Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZbN)**. Komunat e kësaj madhësie konsiderohen partnerë pilot veçanërisht të përshtatshëm, duke pasur parasysh fondet e kufizuara në dispozicion dhe synimin për të mbështetur ndërhyrje të realizueshme, demonstrative dhe të riprodhueshme.

Përmes kësaj Ftese, Programi parasheh të mbështesë **deri në tre komuna** për përgatitjen e dokumentacionit teknik/projektues për projekte prioritare, të cilat më pas mund të dorëzohen për financim nga burime të tjera. Për këtë qëllim, komunave do t'u kërkohet të tregojnë mundësitë e parashikuara për financim të mëtejshëm dhe bashkëfinancim për zbatim, siç janë buxhetet komunale, skemat e qeverisë qendrore, mbështetja e donatorëve, kreditë ose burime të tjera të financimit të jashtëm.

Përveç kësaj, **në varësi të disponueshmërisë së fondeve të Programit** dhe cilësisë e realizueshmërisë së koncepteve të propozuara, **projekti më i mirë dhe më i realizueshëm i ZbN** ndërmjet komunave të përzgjedhura, ose një pjesë e përcaktuar qartë e një projekti të tillë, **mund të konsiderohet gjithashtu për mbështetje në zbatim** nga Programi. **Projekti i renditur i pari** do të marrë gjithashtu **mbështetje profesionale** nga TH Köln – University of Applied Sciences, partner i Programit, për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të konceptit fillestar për aplikimin e ZbN. Për më shumë informata, vizito uebsajtin: TH Köln – University of Applied Sciences.

Kjo Ftesë mbulon **tërë territorin e Kosovës**. Prandaj, komunat që aplikojnë në kuadër të kësaj Ftese duhet të dëshmojnë gatishmërinë për të mbështetur realizimin e projektit dhe të zotohen, në parim, për kushtet kryesore të zbatimit, duke përfshirë, sipas rastit, **disponueshmërinë e tokës, gatishmërinë për leje, bashkëfinancimin, operimin dhe mirëmbajtjen, si dhe aranzhimet për qëndrueshmëri afatgjatë**. Këto zotime do të jenë pjesë e **Deklaratës së Përshtatshmërisë dhe Përputhshmërisë** që duhet të dorëzohet sipas **Shtojcës A**. Komunave gjithashtu do t'u kërkohet të dorëzojnë të **dhënat bazike** të kërkuara nga Programi për të mbështetur llogaritjen e **indekseve të performancës komunale** (Shtojca C), të cilat do të jenë pjesë e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për përzgjedhjen në fazën e ardhshme.

**Shprehja e Interesit** dhe çdo pyetje lidhur me këtë Ftesë duhet të dorëzohen në adresën e dedikuar elektronike: [skatconsultingkosovo@skat.ch](mailto:skatconsultingkosovo@skat.ch).

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen jo më vonë se 18 Qershor, deri në ora 16:30 CEST (Koha Verore e Evropës Qendrore).

## 1. HYRJE

Programi IWRM-K i Qeverive të Zvicrës dhe Kosovës synon të forcojë kapacitetet afatgjata për menaxhimin e resurseve ujore në nivel kombëtar dhe në nivel të pellgjeve lumore, në përputhje me prioritetet socio-ekonomike dhe politike të Kosovës, si dhe me nevojat e zhvillimit të qëndrueshëm. Skema e Granteve Konkurruese (SGK) është një instrument i rëndësishëm për pilotimin e zgjidhjeve praktike, ndërtimin e kapaciteteve lokale dhe nxitjen e zbatimit më të gjerë të prioritetëve që lidhen me ujin përmes partneriteteve të synuara.

Duke u bazuar në rezultatet dhe mësimet e Fazës 1, Faza 2 e vazhdueshme e Programit zgjeron SGK-në për të mbështetur prioritetet në nivel komunal, veçanërisht përmes promovimit të Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (ZbN) dhe përgatitjes së projekteve të tjera komunale të financueshme, të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore dhe rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore në përgjithësi.

### Çfarë janë Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZbN)?

Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZbN) janë ndërhyrje që punojnë në harmoni me natyrën dhe proceset ekosistemike për të adresuar sfidat shoqërore dhe mjedisore në mënyrë të qëndrueshme. Në kontekstin komunal, ato mund të përfshijnë masa si restaurimi i brigjeve të lumenjve, rehabilitimi i ligatinave, korridoret e gjelbra, zonat e infiltrimit dhe retencionit, vegjetacionin për kontrollin e erozionit, infrastrukturën urbane të gjelbër dhe kaltër, si dhe qasje të ngjashme që ndihmojnë në përmirësimin e ruajtjes së ujit, zvogëlimin e rrezikut nga përmytjet dhe erozioni, përmirësimin e cilësisë së ujit, mbështetjen e biodiversitetit dhe forcimin e reziliencës klimatike.

ZbN janë veçanërisht të rëndësishme në rastet kur komunat përballen me sfida që lidhen me ujërat atmosferike, përmytjet lokale, erozionin, degradimin e trupave ujorë, humbjen e hapësirave të gjelbra ose presione më të gjera që ndikojnë në resurset ujore dhe ekosistemet përkatëse.

Përveç masave të veçanta, ZbN mund të konceptohen edhe si një kombinim zgjidhjesh që përforcojnë njëra-tjetrën brenda një konteksti më të gjerë urban, të integruara në planifikimin urban dhe dokumentacionin përkatës të planifikimit komunal. Bazuar në koncepte të tilla të integruara, mund të identifikohen ide individuale për projekte prioritare dhe të zhvillohen më tej përmes dokumentacionit teknik dhe projektues për financim dhe zbatim në të ardhmen.

Si pjesë e kësaj qasjeje, Programi tani fton **komunat në Kosovë me deri në 35,000 banorë<sup>1</sup>**, të cilat i përmbushin kriteret e mëposhtme, të aplikojnë në kuadër të kësaj Ftese për Shprehje Interesi. Qëllimi i kësaj Ftese është të identifikojë komunat me potencialin më të madh për të zhvilluar projekte të realizueshme dhe të riprodhueshme që adresojnë sfidat e lidhura me ujin përmes Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (ZbN) dhe/ose investimeve të tjera prioritare që kërkojnë përgatitje teknike dhe projektuese.

Përmes kësaj Ftese, Programi parasheh të mbështesë deri në tre komuna, me grante deri në 30,000 EUR për projekt, për zhvillimin e dokumentacionit teknik dhe/ose projektues për projekte prioritare komunale. Këto projekte pritet të bëhen më të avancuara dhe të financueshme, duke u mundësuar komunave të aplikojnë për financim nga burime të tjera, përfshirë buxhetet komunale, mekanizmat e qeverisë qendrore, mbështetjen e donatorëve, kreditë ose mundësi të tjera të financimit të jashtëm. Prandaj, komunave aplikuese do t'u kërkohej të tregojnë mundësitë më relevante të financimit që parashohin për zbatim pasi të përgatitet dokumentacioni.

Përveç kësaj, në varësi të disponueshmërisë së fondeve, propozimi më i mirë dhe më i realizueshëm për ZbN ndërmjet komunave të përzgjedhura, ose një komponent i përcaktuar qartë i një propozimi të tillë, mund të konsiderohet gjithashtu për mbështetje në zbatim nga Programi deri në 200,000 EUR. Rrjedhimisht, komunat do të duhet të dëshmojnë gatishmëri lidhur me disponueshmërinë e tokës,

<sup>1</sup> Komunat e kësaj madhësie konsiderohen partnerë pilot veçanërisht të përshtatshëm, duke pasur parasysh fondet e kufizuara në dispozicion dhe synimin për të mbështetur ndërhyrje të dëshmueshme me mundësi reale zbatimi. Të dhënat për popullsinë bazohen në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2024.

lejet, bashkëfinancimin, aranzhimet për zbatim, operimin dhe mirëmbajtjen, si dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Programi synon të bashkëpunojë me komuna proaktive që janë të gatshme ta përdorin këtë mundësi jo vetëm për të përgatitur projekte prioritare, por edhe për të forcuar qasjen e tyre të përgjithshme ndaj menaxhimit të integruar të resurseve ujore në kontekstin lokal. Kjo Ftesë mbulon të gjithë territorin e Kosovës. Komunave do t'u kërkohet të dorëzojnë të dhëna bazë që do t'i mundësojnë Programit të llogarisë indeksin e performancës komunale, i cili do të përbëjë pjesë të procesit të vlerësimit dhe pikëzimit. Në këtë mënyrë, Ftesa kombinon vlerësimin e konceptit të projektit të propozuar me vlerësimin e gatishmërisë dhe performancës më të gjerë të komunës në raport me aspektet relevante të menaxhimit të integruar të resurseve ujore (MIRU). Programi mirëpret veçanërisht ide projektesh që demonstrojnë relevancë të qartë lokale, perspektiva reale zbatimi dhe vlerë më të gjerë si raste pilot.

Zbatimi i aktiviteteve të mbështetura me grant do të kryhet drejtpërdrejt nga Programi IWRM-K përmes kontraktimit të shërbimeve, punimeve dhe mallrave, sipas nevojës. Kjo do të vlejë si për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe projektues, ashtu edhe, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe vendimit të Programit, për çdo mbështetje të mëvonshme në zbatim. Në kuadër të kësaj Ftese nuk parashihet transferim i fondeve grant tek komunat.

Varësisht nga projekti i përzgjedhur, mbështetja mund të përfshijë kontribut profesional nga ekspertët, përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe projektues, si dhe mbështetje të kufizuar në zbatim. Ndarja e detajuar e përgjegjësisë, përfshirë zotimet e komunës lidhur me bashkëfinancimin, lejet, disponueshmërinë e tokës, operimin, mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë, do të përcaktohet në Marrëveshjet përkatëse të Grantit që do të nënshkruhen ndërmjet Programit IWRM-K dhe komunave të përzgjedhura.

## 2. Proceset e Aplikimit dhe Vlerësimit

Do të zbatohen hapat në vijim për përzgjedhjen e komunave:

- a) Shprehja e interesit (ju lutem e shfrytëzoni formën e bashkangjitur si **Shtojca A** për të aplikuar për këtë Ftesë)
- b) Hartimi i Koncept-Dokumentit (formulari i bashkëngjitur si **Shtojca B**). **SHËNIM:** vetëm komunat e përzgjedhura paraprakisht, bazuar në Shprehjen e pranuar të Interesit, do të ftohen të dorëzojnë Koncept-Dokumente.
- c) Përzgjedhja e komunave/përfituesve të grantit dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Grantit (bazuar në cilësinë e përgjithshme të Koncept-Dokumenteve dhe rezultatet e vlerësimit të performancës komunale).

Programi fillimisht do t'i vlerësojë Shprehjet e Interesit për të konfirmuar përputhshmërinë me kriteret e pranueshmërisë dhe për të identifikuar komunat që do të kalojnë në fazën e Koncept-Dokumentit.

Si pjesë e kësaj Ftese për Shprehje të Interesit, komunave gjithashtu u kërkohet të dorëzojnë të dhëna bazë të vetëraportuara (lista e të dhënave të kërkuara paraqitet në **Shtojcën C**), së bashku me dëshmitë mbështetëse aty ku është e aplikueshme, për t'i mundësuar Programit llogaritjen e **indekseve të performancës komunale**. Për qëllime të pikëzimit (vlerësimit) do të merren parasysh vetëm të dhënat që mund të verifikohen në mënyrë të arsyeshme përmes dokumenteve të dorëzuara, evidencave zyrtare ose burimeve të tjera të besueshme.

Tabela më poshtë përmbledh **kriteret provizore të vlerësimit** dhe qasjen përkatëse të pikëzimit që do të përdoret për të vlerësuar Koncept-Dokumentet e dorëzuara nga komunat e përzgjedhura paraprakisht në hapin b), së bashku me rezultatet e indeksit të performancës komunale.

## Kriteret e përkohshme të vlerësimit

Kategoria e vlerësimit	Pikat maksimale
<p><b>Performanca komunale (mjedis/ujë)</b> (bazuar në Shtojcën C)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Performanca bazuar në të dhënat komunale të vetëraportuara dhe të verifikueshme të kërkuara nga Programi</li> <li>Gatishmëria dhe përkushtimi i komunës për t'u angazhuar në procese që lidhen me menaxhimin e integruar të resurseve ujore</li> <li>Disponueshmëria dhe cilësia e sistemeve, të dhënave dhe praktikave relevante komunale që lidhen me përgatitjen e projektit dhe zbatimin e ardhshëm</li> </ul>	15
<p><b>Ideja e projektit dhe relevanca strategjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Relevanca e konceptit të propozuar me objektivat e Ftesës dhe me sfidat komunale që lidhen me ujin</li> <li>Kontributi në përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore, qëndrueshmërisë mjedisore dhe përfitimit më të gjerë publik</li> <li>Qartësia e përcaktimit të problemit dhe përshtatshmëria e zgjidhjes së propozuar</li> </ul>	20
<p><b>Lloji dhe cilësia e konceptit të projektit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pikëzim (vlerësim) më i lartë për konceptet dhe projektet më të gjera të orientuara drejt Zgjidhjeve të Bazuar në Natyrë (ZbN), të integruara në kuadër më të gjerë të planifikimit komunal ose urban (deri në 20 pikë)</li> <li>Pikëzim mesatar për projektet që burojnë nga koncepte më të gjera të integruara, por që paraqiten si komponent prioritar (deri në 15 pikë)</li> <li>Pikëzim më i ulët për projektet e pavarura ose me një qëllim të vetëm, me vlerë të kufizuar integrimi (deri në 10 pikë)</li> </ul>	20
<p><b>Ndikimi dhe fizibiliteti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mundësia që projekti të përgatitet me sukses dhe më pas të zbatohet</li> <li>Madhësia e efekteve pozitive të pritshme mjedisore dhe sociale</li> <li>Numri i njerëzve që pritet të përfitojnë</li> <li>Disponueshmëria e mundësive reale për financim të mëtejshëm për zbatim</li> </ul>	15
<p><b>Qëndrueshmëria, riprodhueshmëria dhe potenciali për zgjerim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mundësia që efektet pozitive të vazhdojnë në afat më të gjatë</li> <li>Potenciali për t'u riprodhuar në komuna të tjera ose për t'u zgjeruar brenda të njëjtës komunë</li> <li>Fuqia e aranzhimeve të propozuara për operim, mirëmbajtje dhe qëndrueshmëri afatgjatë</li> </ul>	15
<p><b>Kapaciteti i aplikantit / përfituesit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kapaciteti i përgjithshëm i komunës për të mbështetur përgatitjen e projektit dhe, kur është e aplikueshme, zbatimin e tij</li> <li>Disponueshmëria e tokës, gatishmëria për leje dhe koordinimi institucional</li> <li>Madhësia dhe probabiliteti i rreziqeve, përfshirë aftësinë e komunës për të adresuar kufizimet gjatë zbatimit</li> </ul>	15
<b>Totali</b>	<b>100</b>

Vlerësimi i aplikimeve do të kryhet nga **komisioni vlerësues** që përfshin ekspertizën e nevojshme teknike. Përzgjedhja përfundimtare e komunave do të bazohet në vlerësimin e kombinuar të pranueshmërisë, performancës komunale dhe cilësisë së konceptit të projektit të propozuar.

**Marrëveshjet përkatëse të Grantit** do të nënshkruhen nga komunat e përzgjedhura dhe zyra dege e **SKAT Consulting Ltd.** në Prishtinë, e cila është përfaqësuesi ligjor i **Programit IWRM-K** në Kosovë.

Komunat e përzgjedhura do të duhet të pajtohen me planet e detajuara të zbatimit, të cilat përcaktojnë fushëveprimin e mbështetjes, përgjegjësitë e palëve, inputet e kërkuara nga komuna, si dhe kërkesat për monitorim dhe raportim. Mekanizmat e monitorimit për secilën komunë të përzgjedhur do të përshtaten në bazë të natyrës së mbështetjes, nivelit të maturitetit të projektit të propozuar dhe hapave të mundshëm të mëtejshëm drejt zbatimit.

Zbatimi i aktiviteteve të mbështetura me grant do të menaxhohet drejtpërdrejt nga **Programi IWRM-K**, përmes kontraktimit të shërbimeve, punimeve dhe mallrave, sipas nevojës. Kjo zbatohet si për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe projektues, ashtu edhe, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe vendimit të Programit, për çdo mbështetje të mëvonshme në zbatim. **Nuk parashihet transferim i drejtpërdrejtë i fondeve të grantit tek komunat në kuadër të kësaj Ftese.**

Nëse një projekt i përzgjedhur kalon në fazën e zbatimit, komuna do të ofrojë bashkëfinancimin e saj të dakorduar përmes një transferimi tek Programi IWRM-K, i cili do të kombinohet me fondet e disponueshme të Programit. Marrëveshjet e detajuara financiare do të përcaktohen në Marrëveshjen e Grantit.

## SHTOJCA A: FORMA PËR SHPREHJEN E INTERESIT

### Informatat bazike

Pika	Informacioni
Emri i komunës	
Kryetari i komunës	
Personi kontaktues, pozita	
Numri i telefonit	
Adresa e emailit	
Lokacioni i komunës (pellgu lumor)	
Popullata e komunës	
Numri i punonjësve të komunës	
SHI e dorëzuar me kohë (data)	
Titulli i propozuar i projektit	
Lloji i projektit të propozuar	<input type="checkbox"/> Projekti i ZbN <input type="checkbox"/> Projekt tjetër komunal i financueshëm
Fondi i kërkuar nga IWRM-K për zhvillimin e projektit (EUR)	
Bashkëfinancimi indikativ i komunës për zbatim të mundshëm (EUR)	
Burimet e pritshme të financimit pasues për zbatim	

### Deklaratë e pranueshmërisë dhe përputhshmërisë me kërkesat minimale

Po	Deklaratë e pranueshmërisë dhe përputhshmërisë me kërkesat minimale	Vërtetimet
<input type="checkbox"/>	<b>Kuptimi i kërkesave:</b> Ne kemi lexuar dhe kemi kuptuar plotësisht kërkesat e kësaj Ftese për Shprehje të Interesit dhe dispozitat përkatëse të Skemës së Granteve Konkurruese.	N/A
<input type="checkbox"/>	<b>Aplikant i pranueshëm:</b> Ne konfirmojmë se aplikanti është një komunë në Kosovë me deri në 35,000 banorë.	Të dhëna zyrtare të popullsisë / profili komunal / burim zyrtar përkatës
<input type="checkbox"/>	<b>Autorizimi institucional:</b> Ne konfirmojmë se komuna është e autorizuar dhe e gatshme të marrë pjesë në këtë Ftesë për Shprehje të Interesit dhe, nëse përzgjidhet, të bashkëpunojë me Programin IWRM-K në përgatitjen e projektit dhe në zbatimin e mundshëm të tij.	Letër e mbështetjes dhe/ose deklaratë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar komunal
<input type="checkbox"/>	<b>Relevanca e projektit:</b> Ne konfirmojmë se projekti i propozuar adreson një sfidë relevante komunale që lidhet me menaxhimin e integruar të resurseve ujore, qëndrueshmërinë mjedisore ose aplikimin përkatës të Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (ZbN).	Përshkrim i shkurtër i projektit / dokument planifikimi komunal / shënim tjetër mbështetës
<input type="checkbox"/>	<b>Dorëzimi i të dhënave për vlerësimin e performancës:</b> Ne pajtohemi të dorëzojmë të dhënat bazike komunale të kërkuara nga Programi dhe kuptojmë se të dhënat e vetëraportuara do të merren parasysh vetëm kur janë të verifikueshme	Shtojca C e plotësuar dhe dokumentet mbështetëse, kur është e aplikueshme
<input type="checkbox"/>	<b>Gatishmëria për t'u angazhuar në konsultime dhe shkëmbim njohurish:</b> Ne shprehim gatishmërinë për të marrë pjesë në takime, konsultime, diskutime teknike, aktivitete komunikimi dhe në ndarjen e mësimave të nxjerra që lidhen me projektin e mbështetur nga Programi.	N/A
<input type="checkbox"/>	<b>Gatishmëria për të ndarë të dhëna relevante të projektit:</b> Ne shprehim gatishmërinë për t'i ndarë me IWRM-K të gjitha të dhënat relevante teknike, hapësinore, institucionale dhe financiare të nevojshme për përgatitjen e projektit dhe, kur është e aplikueshme, për zbatimin e tij.	N/A

<input type="checkbox"/>	<b>Disponueshmëria e tokës:</b> Ne konfirmojmë se komuna është e gatshme dhe në gjendje të sigurojë tokën ose qasjen në lokacionin e nevojshëm për projektin e propozuar, kur është e aplikueshme.	Dokument pronësie, ekstrakt kadastral, dokument i shfrytëzimit të tokës, deklaratë komunale ose dëshmi tjetër relevante.
<input type="checkbox"/>	<b>Gatishmëria për leje:</b> Ne konfirmojmë gatishmërinë për të mbështetur dhe lehtësuar proceset e lejeve dhe miratimeve të nevojshme për projektin e propozuar, kur është e aplikueshme.	Shpjegim i kërkesave për leje (sipas kuptimit të komunës)
<input type="checkbox"/>	<b>Angazhimi për bashkëfinancim komunal:</b> Ne angazhohemi në parim të sigurojmë bashkëfinancim komunal për zbatimin e projektit të propozuar, nëse projekti përzgjidhet për mbështetje në zbatim.	Deklaratë komunale / zotim buxhetor indikativ / vendim ose deklaratë nga autoriteti kompetent.
<input type="checkbox"/>	<b>Operimi dhe mirëmbajtja:</b> Ne konfirmojmë gatishmërinë për të marrë përsipër përgjegjësinë për operimin dhe mirëmbajtjen e investimit të mbështetur, kur është e aplikueshme, dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tij afatgjatë.	Deklaratë komunale / akt i brendshëm përkatës ose deklaratë.
<input type="checkbox"/>	<b>Potenciali për financim pasues:</b> Ne konfirmojmë se komuna ka identifikuar mundësi reale financimi për zbatimin e projektit pas përgatitjes së dokumentacionit teknik/projektues.	N/A
<input type="checkbox"/>	<b>Shmangia e financimit të dyfishtë zviceran:</b> Ne deklarojmë se komuna nuk po përfiton financim nga donatorët zviceranë për zbatimin e të njëjtave masa për të cilat kërkohet mbështetje në kuadër të kësaj Ftese.	Deklaratë komunale
<input type="checkbox"/>	<b>Mosfinancimi i aktiviteteve të papranueshme:</b> Ne deklarojmë se asnjë mbështetje e kërkuar në kuadër të kësaj Ftese nuk lidhet me aktivitete politike apo me qëllime të tjera të papranueshme.	Deklaratë komunale
<input type="checkbox"/>	<b>Konflikti i interesit:</b> Ne garantojmë se komuna nuk ka asnjë konflikt interesi aktual, potencial ose të perceptuar në paraqitjen e kësaj aplikimi.	Deklaratë komunale
<input type="checkbox"/>	<b>Kapaciteti financiar dhe institucional:</b> Ne deklarojmë se komuna është në gjendje të bashkëpunojë në mirëbesim me Programin dhe të përmbushë obligimet që mund të dalin nga përgatitja e projektit dhe, kur është e aplikueshme, nga zbatimi i tij.	Deklaratë komunale dhe çdo dokument mbështetës përkatës.
<input type="checkbox"/>	<b>Pranimi i modalitetit të zbatimit të Programit:</b> Ne kuptojmë dhe pranojmë se aktivitetet e mbështetura me grant do të zbatohen drejtpërdrejt nga Programi IWRM-K përmes kontraktimit të shërbimeve, punimeve dhe mallrave, dhe se nuk parashihet transferim i drejtpërdrejtë i fondeve të grantit tek komuna në kuadër të kësaj Ftese.	N/A
<input type="checkbox"/>	<b>Pranimi i aranzhimeve për bashkëfinancim në zbatim:</b> Ne kuptojmë se, nëse projekti përzgjidhet për mbështetje në zbatim, bashkëfinancimi i dakorduar i komunës do të transferohet tek Programi IWRM-K.	N/A

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri/Mbiemri: [Click or tap here to enter text.](#)

Pozita: [Click or tap here to enter text.](#)

Data: [Click or tap to enter a date.](#)

## Përshkrim i shkurtër i konceptit të propozuar

Ideja e dorëzuar për shqyrtim për grant duhet të shtjellohet shkurt duke iu përgjigjur pyetjeve më poshtë. Informacioni i ofruar do të përdoret për të vlerësuar relevancën, fizibilitetin, gatishmërinë dhe potencialin më të gjerë të projektit të propozuar.

Seksioni	Pyetje udhëzuese / informacioni që duhet të ofrohet
<b>1. Përshkrimi i konceptit të propozuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë dëshiron të bëjë komuna dhe çfarë synon të arrijë në fund?</li> <li>A është propozimi i fokusuar në një Zgjidhje të Bazuar në Natyrë (ZbN) ose në ndonjë projekt tjetër komunal të financueshëm?</li> <li>A është propozimi një projekt i pavarur apo pjesë e një koncepti më të gjerë të orientuar drejt ZbN ose një kornize të planifikimit urban/komunal?</li> <li>Si lidhet koncepti me objektivat e Skemës së Granteve Konkurruese (SGK) dhe të kësaj Ftese për Shprehje të Interesit?</li> </ul>
<b>2. Arsyetimi dhe relevanca strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë problemi apo sfide specifike synon të adresojë komuna?</li> <li>Pse ky projekt është prioritet për komunën?</li> <li>Si do të kontribuojë koncepti i propozuar në përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore, qëndrueshmërisë mjedisore dhe përfitimeve më të gjera publike?</li> <li>Cilat janë përfitimet e pritshme për komunën, mjedisin dhe popullatën lokale?</li> </ul>
<b>3. Gatishmëria komunale dhe baza ekzistuese</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë të dhënash ekzistuese komunale, studimesh, planesh, hartash, konceptesh ose dokumentesh të tjera janë në dispozicion dhe janë relevante për projektin e propozuar?</li> <li>Çfarë informacioni ka tashmë komuna për lokacionin, zonën e prekur, problemin mjedisor, statusin e pronësisë, kufizimet teknike ose nevojat e zbatimit?</li> <li>Çfarë kapacitetesh të brendshme, përvoja të mëparshme ose mbështetje nga partnerët ka komuna që mund të ndihmojnë përgatitjen e projektit dhe zbatimin e ardhshëm?</li> </ul>
<b>4. Lloji i mbështetjes së kërkuar nga IWRM-K</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë lloj mbështetjeje kërkohet nga IWRM-K?</li> <li>Çfarë lloj dokumentacioni teknik dhe/ose projektues pritet të përgatitet?</li> <li>A ekziston nevoja për përmirësim të konceptit, studime ekspertësh, shërbime projektuese, mbështetje për leje (leje ndërtimi/administrative), vlerësime të kostove ose planifikim të zbatimit?</li> <li>Nëse është e rëndësishme, cila pjesë e projektit mund të konsiderohet për mbështetje të mundshme në fazën e mëvonshme të zbatimit?</li> </ul>
<b>5. Financimi i pritshëm pasues dhe perspektivat e zbatimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë mundësish financimi parashikon komuna për zbatimin e projektit pasi të përgatitet dokumentacioni?</li> <li>Ju lutemi tregoni burimet më të mundshme (p.sh. buxheti komunal, skema të qeverisë qendrore, fonde donatore, kredi, mbështetje nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFI), të tjera).</li> <li>Sa realiste janë këto mundësi dhe cili do të ishte roli i komunës në sigurimin e tyre?</li> </ul>
<b>6. Rezultatet e pritshme dhe afati kohor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Cilat janë përfitimet kryesore mjedisore dhe sociale të pritshme?</li> <li>Kush pritet të përfitojë dhe në çfarë mënyre (ju lutemi jepni të dhëna sasiore për përfituesit)?</li> <li>Cilat janë rreziqet ose kufizimet kryesore?</li> <li>Cilat masa parashikohen për të mbështetur qëndrueshmërinë (përfshirë funksionimin dhe mirëmbajtjen e ardhshme)?</li> <li>Cili është afati kohor indikativ për përgatitjen e projektit dhe zbatimin e mundshëm?</li> </ul>

<b>7. Shpjegimi se si do të përmbushen deklaratat</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ju lutemi shpjegoni shkurtimisht se si komuna synon të përmbushë deklaratat kryesore të bëra në këtë Shprehje Interesi (SHI), në lidhje me projektin e propozuar, duke përfshirë:<ul style="list-style-type: none"><li>- zotimin për bashkëfinancim</li><li>- disponueshmërinë e tokës / qasjen në lokacion</li><li>- gatishmërinë dhe mbështetjen për lejet (permitting)</li><li>- marrëveshjet për operim dhe mirëmbajtje</li><li>- përgjegjësitë institucionale dhe koordinimin</li><li>- qëndrueshmërinë afatgjatë</li><li>- disponueshmërinë e të dhënave dhe bashkëpunimin me Programin</li></ul></li></ul>
---	---

Aplikantët inkurajohen që përgjigjet e tyre t'i mbajnë të shkurtra dhe praktike, duke ofruar megjithatë detaje të mjaftueshme për të mundësuar një vlerësim objektiv të konceptit të projektit dhe gatishmërisë së komunës.

## SHTOJCA B: KONCEPT DOKUMENTI

### Udhëzimet bazike

- Ky Koncept Dokument nuk duhet të plotësohet nga aplikantët në fazën e Shprehjes së Interesit (SHI).
- Vetëm tre komunat më të vlerësuara, bazuar në vlerësimin dhe pikëzimin e fazës së SHI, do të ftohen të përgatisin dhe dorëzojnë një Koncept Dokument.
- Komunat e ftuara duhet të përgatisin Koncept Dokumentin duke përdorur këtë format të përcaktuar. Ju lutemi të ofroni informacionin e kërkuar në mënyrë të qartë, të përmbledhur dhe të drejtpërdrejtë.
- Ju lutemi lexoni me kujdes tekstin udhëzues përpara përgatitjes së Koncept Dokumentit.

Pika	Informacioni
Emri i Komunës	
Personi kontaktues, pozita	
Detajet kontaktuese	
Buxheti i propozuar i kërkuar nga IWRM-K për zhvillimin e projektit (EUR)	
Kontributi i propozuar i komunës për zbatimin e mundshëm (EUR)	
Titulli i projektit të propozuar	
Lloji i projektit të propozuar	<input type="checkbox"/> Projekt ZbN <input type="checkbox"/> Projekt tjetër komunal i financueshëm <input type="checkbox"/> I Kombinuar

### 1. Profili i Komunës / Organizatës

Ju lutemi të ofroni një prezantim të shkurtër të komunës. Prezantimi duhet të përfshijë informata bazë për komunën, administratën komunale dhe strukturën e qeverisjes, departamentet ose njësitë relevante, si dhe përvojën e mëparshme të komunës, nëse ka, në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve në fushat e ujit, mjedisit, reziliencës klimatike, zhvillimit urban ose infrastrukturës së ngjashme. Ju lutemi gjithashtu të përshkruani sfidat kryesore që lidhen me ujin dhe mjedisin, të rëndësishme për konceptin e propozuar, si dhe kapacitetet dhe kufizimet aktuale të komunës në adresimin e tyre.

**(Maksimumi 500 fjalë)**

### 2. Elaborati i Kërkesave

#### a. Përshkrimi i qasjes / konceptit të propozuar

Ju lutemi përshkruani qartë dhe në mënyrë të përmbledhur konceptin e projektit të propozuar. Tregoni nëse projekti është i fokusuar në Zgjidhje të Bazuara në Natyrë (ZbN), në një projekt tjetër komunal të financueshëm apo në një kombinim të të dyjave. Shpjegoni nëse projekti është një ndërhyrje e pavarur ose pjesë e një koncepti më të gjerë të zhvillimit komunal / urban apo një plani të orientuar drejt ZbN.

**(Maksimumi 300 fjalë)**

#### b. Arsyetimi i konceptit të propozuar

Ju lutemi të justifikoni arsyet pas konceptit, duke u fokusuar në:

- Cili është objektivi kryesor i ndërhyrjes?
- Cilën sfidë apo kufizim specifik komunal e adreson?

- Si do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore, reziliencës mjedisore dhe përfitimit publik?
- Si i përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të identifikuara në fazën e SHI (Shprehjes së Interesit) **(Maksimumi 300 fjalë)**

### c. Vlera e shtuar dhe inovacioni

Ju lutemi shpjegoni çfarë e bën inovativ, strategjik ose veçanërisht të vlefshëm konceptin e propozuar. Për shembull:

- A bazohet në një qasje të integruar të Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë (ZbN)?
- A është pjesë e një kuadri më të gjerë të planifikimit komunal?
- A mund të shërbejë si pilot ose rast demonstrues për komuna të tjera?
- A kombinon në mënyrë të rëndësishme përfitime mjedisore, sociale dhe të zhvillimit urban? **(Maksimumi 200 fjalë)**

### d. Nevoja për mbështetje të jashtme

Ju lutemi të shpjegoni pse kërkohet mbështetje e jashtme për përgatitjen dhe, kur është e zbatueshme, edhe për zbatimin e mundshëm të projektit. Çfarë aktualisht e pengon komunën që ta çojë projektin përpara në mënyrë të pavarur, dhe çfarë ka gjasa të ndodhë nëse një mbështetje e tillë nuk ofrohet? **(Maksimumi 150 fjalë)**

## 3. Vazhdimësia dhe mundësia e zgjerimit të konceptit të propozuar

### a. Perspektiva e zbatimit

Ju lutemi të shpjegoni planin e komunës për të çuar projektin përpara pas marrjes së mbështetjes së Programit për përgatitjen e dokumentacionit teknik/dizajnit. Përshkruani hapat e pritshëm drejt zbatimit, përfshirë rolin dhe përgjegjësitë e komunës. **(Maksimumi 300 fjalë)**

### b. Potenciali për shkallëzim dhe replikim

Ju lutemi të shpjegoni nëse koncepti ka potencial për t'u replikuar në zona të tjera brenda komunës ose në komuna të tjera, ose nëse mund të shkallëzohet në një ndërhyrje më të gjerë komunale. **(Maksimumi 300 fjalë)**

### c. Qëndrueshmëria

Ju lutemi të shpjegoni se si ndikimet pozitive të konceptit të propozuar pritet të vazhdojnë në afat të gjatë. Referojuni, kur është e rëndësishme, pronësisë institucionale, operimit dhe mirëmbajtjes, financimit afatgjatë, pranimin nga komuniteti, qëndrueshmërisë mjedisore dhe integritimit në planifikimin dhe buxhetimin komunal.

**(Maksimumi 300 fjalë)**

## 4. Aktivitetet kryesore

Ju lutem listoni aktivitetet kryesore ose ndërhyrjet që do të duhet të kryhen në kuadër të projektit të propozuar. Këto mund të përfshijnë, sipas rastit, përmirësimin e konceptit, anketime, studime, hetime teknike, punë projektuese, mbështetje për lejet, vlerësim të kostove, përgatitje të dokumentacionit të gatshëm për tender, si dhe zbatimin e mundshëm të një komponenti pilot të përcaktuar. **(Maksimumi 300 fjalë)**

## 5. Përmbledhje e Përfitimeve

Ju lutem përmbledhni efektet e pritshme të ndërhyrjes së propozuar. Kjo duhet të përfshijë, sipas rastit:

- Përfitimet e pritshme mjedisore
- Përfitimet e pritshme të lidhura me ujin

- Përmbledhje e përfitimeve sociale, duke përfshirë popullsinë që pritet të përfitojë
- Vlera të tjera të rëndësishme që mbrohen ose përmirësohen (p.sh. hapësirat publike, biodiversiteti, rezistenca ndaj klimës, kontrolli i erozionit, zbutja e përmytjeve, etj.)  
**(Maksimumi 150 fjalë)**

## 6. Gatishmëria dhe angazhimet e komunës

Ju lutem shpjegoni se si komuna do t'i përmbushë kushtet kryesore për përgatitjen e suksesshme të projektit dhe zbatimin e mundshëm, duke përfshirë, sipas rastit:

- disponueshmërinë e tokës ose qasjen në vendndodhje
- gatishmërinë për leje dhe autorizime
- koordinimin komunal dhe përgjegjësitë institucionale
- disponueshmërinë e të dhënave
- gatishmërinë për bashkëfinancim
- rregullimet për operim dhe mirëmbajtje
- angazhimin për qëndrueshmëri afatgjatë **(Maksimumi 300 fjalë)**

## 7. Kushtet e financimit

Ju lutem tregoni strukturën e pritshme të buxhetit të projektit të propozuar. Në këtë fazë, tabela duhet të paraqesë vlerësimin indikativ të komunës për vlerën totale të projektit, duke përfshirë mbështetjen e kërkuar nga IWRM-K për zhvillimin e projektit dhe, kur është e zbatueshme, kontributin indikativ të komunës për zbatimin e mundshëm.

Kostoja (EUR)	Kontributi i Komunës	Kontributi i kërkuar nga IWRM-K	Totali
Koha e stafit		/	
Asistencë teknike			
Anketime / studime / hetime			
Projektim / dokumentacion teknik			
Mbështetje për leje / miratime			
Punime / zbatim (nëse aplikohet)			
Pajisje (nëse aplikohet)			
Të tjera*			
<b>Kostoja totale e projektit</b>			
<b>Përqindja %</b>			100%

\* Përdorni linja shtesë buxhetore në përputhje me nevojat e propozimit.

## SHTOJCA C: KËRKESAT PËR TË DHËNAT KOMUNALE

Për të mbështetur një proces vlerësimi transparent dhe të bazuar në prova, komunat duhet të ofrojnë një grup të përcaktuar të të dhënave bazë komunale dhe informacionit mbështetës. Qëllimi i kësaj shtojce është t'i mundësojë Programit IWRM-K llogaritjen e një sërë indeksesh të performancës komunale, të cilat do të përdoren si pjesë e procesit të vlerësimit, duke përmirësuar gjithashtu kuptimin e Programit për performancën aktuale të komunës dhe gatishmërinë e saj në lidhje me menaxhimin e ujërave, mbrojtjen e mjedisit dhe qëndrueshmërinë.

Të dhënat duhet të bazohen në regjistrimet më të fundit zyrtare komunale ose burime të tjera të besueshme dhe të verifikueshme. Informacioni i vetë-deklaruar mund të pranohet vetëm kur mbështetet me prova të përshtatshme.

Tabela më poshtë paraqet strukturën e kërkesave për të dhënat komunale.

Indikator relevant	Kërkesat për të dhënat komunale	Njësia	Formula e aplikuar	Pikët
<b>I.1. Shpenzimet buxhetore komunale për projekte të lidhura me sektorin e ujit për kokë banori</b>	Buxheti vjetor komunal i alokuar në vitet 2023–2025 për sektorin e ujit (duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujërave të ndotura, drenazhin, rrjetin e ujitjes, ujërat e shiut, mbrojtjen nga përmytjet, mbrojtjen e lumenjve, infrastrukturën e gjelbër, kontrollin e ndotjes së ujit, mbrojtjen mjedisore/ujore dhe masat përkatëse të qëndrueshmërisë);	EUR	Alokimet totale vjetore për sektorin e ujit ÷ Popullsia totale (EUR)	3
	Popullsia totale komunale (Regjistrimi i Popullsisë 2024)	Nr.		
<b>I.2. Përpjekja për investime kapitale në infrastrukturën ujore</b>	Investimet vjetore komunale të realizuara në vitet 2023–2025 në sektorin e ujit (duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujërave të ndotura, drenazhin, rrjetin e ujitjes, ujërat e shiut, mbrojtjen nga përmytjet, mbrojtjen e lumenjve, infrastrukturën e gjelbër, kontrollin e ndotjes së ujit, mbrojtjen mjedisore dhe masat përkatëse të qëndrueshmërisë).	EUR	Buxheti total i alokuar për sektorin e ujit ÷ Buxheti total i alokuar për investime kapitale komunale (shih I.1.) (%)	1.5
	Buxheti total komunal 2023–2025		Investimi total kapital në sektorin e ujit ÷ Buxheti total i alokuar për sektorin e ujit (%)	1.5
<b>I.3. Zgjerimi i mbulimit të shërbimeve ekzistuese rajonale të furnizimit publik me</b>	Lista e vendbanimeve komunale të lidhura me kompaninë përkatëse rajonale të ujësjellësit (KRU) në vitet 2023–2025.	Teksti & Nr.	Popullsia totale e vendbanimeve të lidhura ÷ Popullsia totale e pambuluar nga	4

ujë në vendbanimet komunale	Popullsia totale e vendbanimeve të lidhura (Regjistrimi i Popullsisë 2024)	Nr.	furnizimi publik me ujë në komunë (%)	
	Popullsia totale e pambuluar nga furnizimi publik me ujë në komunë, përfshirë edhe ata që janë mbuluar gjatë viteve 2023–2025 (Regjistrimi i Popullsisë 2024).	Nr.		
			<b>Pikët në total</b>	<b>10</b>

### Shënim

- Komunat do të kërkohet të ofrojnë të dhënat bazike së bashku me shpjegime të shkurtra dhe prova mbështetëse.
- Qasja përfundimtare e vlerësimit mund të kombinojë indikatorë sasiorë dhe elemente të vlerësimit cilësor.
- Programi mund të normalizojë disa indikatorë për kokë banori, për km<sup>2</sup>, ose si pjesë e buxhetit total, varësisht nga ajo që është më e përshtatshme për krahasueshmëri.
- Rezultati përfundimtar total sipas Shtojcës C do të kontribuojë në procesin e përgjithshëm të vlerësimit dhe renditjes në kuadër të Ftesës për Shprehje Interesi (SHI). Deri në 10 nga 15 pikët për performancën mjedisore/ujore komunale do të jepen në bazë të rezultatit të llogaritur nga indekset për të cilat komunat do të ofrojnë të dhëna.
- Komunat që nuk dorëzojnë të dhënat e kërkuara të performancës do të përjashtohen gjatë fazës së SHI.